



BEDRI HAMZA SHPALL KANDIDATURËN PËR KRYETAR TË PDK-së, MERR MBËSHTETJE NGA FIGURAT QENDRORE TË PARTISË

Nënkryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka bërë publike kandidaturën për kryetar të PDK-së në Konventën e partisë më 17 nëntor. Pas njoftimit zyrtar, shumica e figurave kryesore të kësaj partie kanë dalë në përkrahje të kandidaturës së Hamzës. Ende nuk dihet nëse do të ketë kandidaturë tjetër në Konventën Zgjedhore të PDK-së, ndërsa deputeti Enver Hoxhaj ka kërkuar shtyrjen e konventës për një javë

KOSOVA ENDE NË UDHËKRYQ

F.7



HULUMTIMI: MUNGESA E BESIMIT, NDËR PENGESAT MË TË MËDHA PËR BASHKËJETESË NDËRETNIKE NË KOSOVË

F.7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



TË DIELËN PROTESTOHET NË
STRASBURG PËR PADREJTËSITË
NË HAGË F.6

OSMANI KRITIKON BE-në QË S'PO E
VLERËSON PUNËN E KOSOVËS F.5

MINISTRI I MBROJTJES: SIGURIA
KIBERNETIKE DUHET TRAJTUAR SI
INVESTIM STRATEGJIK NË TË
ARDHMEN F.6

SHSKUK-ja FURNIZOHET ME
MATERIALE TË MJAFTUESHME PËR
SHËRBIMET E HEMODIALIZËS F.6

EKONOMI



ZËVENDËSGUVERNATORI ÇAKAJ:
MENAXHIMI STRATEGJIK I
RREZIQEVE, THELBËSOR NË NJË
TREG FINANCIAR QË PO NDRYSHON
ME RITME TË SHPEJTA F.8

SPORT



HISTORIA SHKRUHET NË ANDORRA,
SHQIPËRIA SIGURON FAZËN E
"PLAY-OFF"-it PËR BOTËTORIN F.11

NË GJERMANI ARRIHET PAJTUESHMËRI PËR SHËRBIMIN E RI USHTARAK

Berlin, 14 nëntor- Koalicioni qeveritar në Gjermani është pajtuar për një plan të ri ushtarak me qëllim të rritjes së numrit të trupave, pas disa muajve të mosmarrëveshjeve mes forcave politike. Plani i ri për shërbimin ushtarak parasheh që të gjithë djemtë 18-vjeçarë të plotësojnë një formular rreth gatishmërisë së tyre për të shërbyer dhe nga viti 2027 do t'i nënshtrohen një kontrolli mjekësor. Ky vendim është marrë teksa Berlini përpaket të krijojë ushtrinë më të fuqishme konvencionale në Evropë. Shefi i kompanisë më të madhe gjermane në fushën e Mbrojtjes ka bërë të ditur për mediat se

beson që synimi mund të arrihet brenda pesë vjetësh. Ligjvënësit pritet ta votojnë këtë plan deri në fund të vitit 2025. Më herët gjatë vitit, shefi i Mbrojtjes në Gjermani, gjenerali Carsten Breuer ka paralajmëruar që aleanca e NATO-s duhet të përgatitet për ndonjë sulm të mundshëm rus brenda katër vjetësh. Kur e kanë formuar koalicionin qeveritar më herët gjatë vitit, konservatorët e kancelarit Friedrich Merz dhe Social-Demokratët e qendrës së majtë janë pajtuar për ta rikthyer shërbimin ushtarak, i cili fillimisht do të jetë në baza vullnetare. Ushtria gjermane i ka aktualisht

rreth 182.000 ushtarë. Shërbimi i ri ushtarak mëton të rrisë këtë numër për 20.000 vitin e ardhshëm, dhe që shifra të rritet mes 255.000 dhe 260.000 në 10 vjetët e ardhshëm, me 200.000 rezervistë shtesë. Disa parti politike të krahut të majtë vazhdojnë të kundërshtojnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Edhe shumë të rinj gjermanë janë në këtë linjë. Një anketë e realizuar së fundmi për revistën Stern ka sugjeruar se pak mbi gjysma e respondentëve e pëlqejnë shërbimin e detyrueshëm, mirëpo shkalla e kundërshtimit është 63 për qind te grup-mosha 18-29 vjeç.



KINA PËRPLASET ME JAPONINË, DEKLARATA E KRYEMINISTRES JAPONEZE PËR ISHULLIN E TAJVANIT BËHET “MOLLË SHERRI”



Pekin, 14 nëntor- Një deklaratë e kryeministres së Japonisë tregoi brishtësinë e marrëdhënieve Japoni-Kinë. Kjo e fundit thirri ambasadorin japonez në takimurgjent, pasi javën e kaluar, kryeministrja e re japoneze, Sanae Takaichi, i tha parlamentit se në rast sulmesh të armatosura ndaj Tajvanit, Japonia mund të justifikohet me dërgimin e trupave për të mbështetur ishullin. Nëse një emergjencë në Tajvan përfshin “anije luftarake dhe përdorimin e forcës, atëherë kjo

mund të përbëjë një situatë që kërcënon mbijetesën e Japonisë”, tha ajo. Pekini këmbëngul se Tajvani është pjesë e territorit të tij dhe nuk e ka përjashtuar përdorimin e forcës për të marrë kontrollin e ishullit vetëqeverisës. Përmes reagimeve publike Kina i bëri të qartë Japonisë se “Nëse guxon të ndërhyjë në kauzën e bashkimit të Kinës në çfarëdo forme, do të marrë një kundërpërgjigje të fuqishme”. Kina kërkoi më tej që pala japoneze të korrigjojë

menjëherë deklaratën, por kryeministrja Takaichi këmbënguli se ajo ishte në përputhje me qëndrimin e mëparshëm të Tokios. Japonia thotë se qëndrimet e saj janë në përputhje me Komunikatën e Përbashkët Japoni-Kinë të vitit 1972”. Komunikata e vitit 1972 normalizoi marrëdhëniet dypalëshe, me Japoninë që pranoi politikën “Një Kinë”, të njohur nga shumë vende të tjera, përfshirë Shtetet e Bashkuara.

POLONIA NIS PËRGATITJET USHTARAKE PËR FËMIJËT, PUNËTORËT DHE PENSIONISTËT

Varshavë, 14 nëntor- Polonia ndihet gjithnjë e më e kërcënuar nga Rusia dhe planifikon përgatitje ushtarake vullnetare për një numër të madh civilësh. Çfarë synon programi “Në Gatishmëri”? Nga nxënësit e shkollave fillore deri te të moshuarit: Polonia po i fton qytetarët e saj të marrin pjesë në trajnime dhe stërvitje ushtarake vullnetare. Programi “Në Gatishmëri” përfshin nga trajnime se si të mbijetosh deri te mbrojtja nga sulmet kibernetike. Vetëm këtë vit pritet të trajnohen 20,000 vetë, njoftoi Ministria e Mbrojtjes në Varshavë. Deri në vitin 2026 ky numër pritet të arrijë në 400,000. Ky është programi më i madh stërvitor ushtarak në historinë e Polonisë. Arsyeja është qëndrimi

i Rusisë, të cilën Polonia e sheh gjithnjë e më shumë si kërcënim. Faza pilot e projektit fillon më 22 nëntor, tha Ministri i Mbrojtjes Wladyslaw Kosiniak-Kamysz në Varshavë. “Po jetojmë në kohët më të rrezikshme që nga Lufta e Dytë Botërore. Në vendin fqinjë, në Ukrainë, po zhvillohet luftë, ka akte sabotimi në Detin Baltik dhe beteja në hapësirën kibernetike”, tha Kosiniak-Kamysz. Këto janë edhe arsyet pse po zhvillohet ky program.

Rezervim përmes aplikacionit

Programi u drejtohet “të gjithë qytetarëve polakë që dëshirojnë të marrin pjesë”: fëmijë, punëtorë, pensionistë - me fjalë të tjera, civilë polakë të



pothuajse të gjitha grupmoshave. Vullnetarët do të trajnohen si individualisht ashtu edhe në grupe. Programi përbëhet nga katër module: njohuri bazë për temën e sigurisë, aftësitë për të

mbijetuar, ndihma e parë dhe siguria kibernetike. Sesionet e trajnimit zhvillohen gjatë fundjavave, dhe secili modul zakonisht zgjat një ditë. Ministria e Digjitalizimit njoftoi se qytetarët e interesuar mund

të regjistrohen përmes aplikacionit të administratës shtetërore “mObywatel”.

E kërcënuar nga Rusia

Gjatë prezantimit të programit “Në Gatishmëri” zëvendësministri i Mbrojtjes, Cezaryk Tomczyk, bëri të qartë se qëllimi i tij është “të forcojë aftësitë mbrojtëse kombëtare dhe rezistencën shoqërore” për shkak të luftës në Ukrainë, e cila po vazhdon prej më shumë se tre vjet e gjysmë. Sipas sqarimeve të tij kurset dhe stërvitjet në kuadër të programit “Në gatishmëri” nuk janë të barabarta me shërbimin në ushtri; në fund t tyre nuk bëhet betim apo regjistrim në listën e rezervistëve. (dw)

BEDRI HAMZA SHPALL KANDIDATURËN PËR KRYETAR TË PDK-së, MERR MBËSHTETJE NGA FIGURAT QENDRORE TË PARTISË

Nënkryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka bërë publike kandidaturën për kryetar të PDK-së në Konventën e partisë më 17 nëntor. Pas njoftimit zyrtar, shumica e figurave kryesore të kësaj partie kanë dalë në përkrahje të kandidaturës së Hamzës. Ende nuk dihet nëse do të ketë kandidaturë tjetër në Konventën Zgjedhore të PDK-së, ndërsa deputeti Enver Hoxhaj ka kërkuar shtyrjen e konventës për një javë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Bedri Hamza ka njoftuar se do të garojë për kryetar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Konventën e partisë më 17 nëntor. Ai e shpalli kandidaturën një ditë pasi kryetari i deritanishëm, Memli Krasniqi, dha dorëheqje dhe tha se do ta mbështeste Hamzën, nëse ky i fundit do të garonte për ta pasuar. "Sot, me përgjegjësi dhe besim në të ardhmen e partisë sonë, e shpalli kandidaturën time për Kryetar të PDK-së", shkroi Hamza në "Facebook". Hamza, i cili garoi për kryeministër të vendit nga kjo parti në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, duke dalë i dyti - tha se beson se PDK-ja ka forcën për t'u unifikuar, reformuar dhe rikthyer "si partia kryesore në vend". "Tani është koha për një PDK të bashkuar, që lufton për drejtësi, zhvillim dhe një Kosovë evropiane. PDK është familja jonë dhe së bashku do ta hapim kapitullin e ri të fitoreve", shtoi ai. Hamza në të kaluarën ka qenë ministër i Financave dhe Ekonomisë, deputet në legjislaturat paraprake të Kuvendit të Kosovës si dhe guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës. Krasniqi njoftoi të mërkurën për dorëheqje nga kryetari i partisë, duke thënë se ka ardhur koha

për një mundësi të re për "familjen tonë demokratike". Dorëheqja e tij vjen pesë muaj pasi ai ishte rizgjedhur në krye të partisë për një mandat të dytë në qershor. PDK-ja përveç që doli e dyta në zgjedhje parlamentare në shkurt, ajo i fitoi gjashtë komuna në zgjedhje lokale të këtij viti, duke pësuar një rënie të vogël në nivel lokal, në krahasim me zgjedhjet paraprake. Zyrtarizmi i kandidaturës së Bedri Hamzës për kryetar të PDK-së ka nxitur reagimin e figurave kryesore të kësaj partie. Ndër të parët që ka reaguar është Vlora Çitaku, sekretare e përgjithshme e PDK-së. Në profilin e tij në "Facebook", ajo ka shpërndarë postimin e Hamzës, duke thënë se me Hamzën PDK-ja do të hapë një kapitull të ri. "PDK është familja jonë dhe së bashku do ta hapim kapitullin e ri të fitoreve", ka shkruar Çitaku. Edhe shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, e ka mirëpritur kandidaturën e Hamzës. Ai ka bërë me dije se ky është një hap i rëndësishëm për rikthimin e PDK-së si partia fituese në vend. "Bedri Hamza sot zyrtarizoi kandidaturën për kryetar të PDK-së. Një hap i rëndësishëm për rikthimin e PDK-së si partia fituese në vend. Bedri Hamza do të jetë kryeministri i ardhshëm i Kosovës", ka shkruar Tahiri në "Facebook".



Pas dorëheqjes nga pozita e kryetarit, edhe Memli Krasniqi ka thënë se nuk e fsheh preferencën e tij për Bedri Hamzën. Në konferencën për medie, Krasniqi ka thënë se kryetari i PDK-së duhet të jetë edhe kandidat për kryeministër. "Unë jam i bindur që kandidati i PDK-së për kryeministër duhet të jetë Bedri Hamza. Sepse, po ashtu, jam i bindur se është kryeministri më i mirë që mund ta ketë Kosova sot. Dhe natyrisht që nëse miku im Bedri Hamza kandidon për të qenë kryetar i PDK-së, ai e ka mbështetjen time të plotë. Sepse besoj në liderhipin e tij, dhe besoj se është figura e cila mund t'i prijë PDK-së në fazën e ardhshme", ka thënë ai, duke shtuar se gara për të parin e partisë tash është e hapur. "Gara është e hapur. Kushdo që i plotëson kriteret satutare ka të drejtë të garojë. Ka pasur gjithmonë. Dy herët që kam

garuar unë nuk kam pasur kundërkandidat. Nuk mund të them se a do të ketë tash. Nuk mund të them për askënd që do të garojë, por preferencën time për Bedri Hamzën nuk e fsheh, përkundrazi, me kënaqësi e bëj publike", ka thënë Krasniqi. Pas dorëheqjes së Krasniqit, edhe kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, është rreshtuar pas Hamzës. "Besimi im në sinqeritetin e anëtarësisë, ashtu dhe udhëheqësve të PDK-së, ka qenë i madh. Ky hap i pritshëm i kryetarit të deritashëm, Memli Krasniqi do përshëndetur, njëherësh, duke i ofruar fuqishëm përkrahje kryetarit në ardhje, Bedri Hamza", ka shkruar Lladrovci në profilin e tij në "Facebook". Ndonëse nuk dihet se sa kandidatura do të jenë, deputeti i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka kërkuar që të shtyhet konventa për zgjedhjen e kryetarit sepse, sipas tij, një

parti serioze nuk mund të mbajë një konventë politike dhe përmbajtjesore në një kohë kaq të shkurtër. "Kërkoj nga Kryesia e PDK-së shtyrjen e Konventës për të paktën deri të dielën e ardhshme, sepse kështu do u jepej mundësia anëtarësisë dhe delegatëve të njihen me kandidaturat dhe platformat për zhvillimin e partisë dhe për çështje serioze që prekin vendin. Kjo do ta rriste cilësinë e kandidaturave dhe konkurrencën ndërmjet platformave, pasi zhvillimet e fundit kanë qenë të befasishme", ka shkruar Hoxhaj në "Facebook". Sipas tij, kjo nguti nuk garanton garë cilësore, as reformimin dhe unitetin e kërkuar e të domosdoshëm për PDK-në në këtë kohë. "Në partitë demokratike, më shumë se një kandidaturë është mundësi për delegatët që të zgjedhin lirisht dhe ndihmon në pasurimin e platformave individuale, duke çuar në ndërtimin e një platforme të përbashkët për PDK-në. Për një vendimmarrje kaq të rëndësishme, kërkoj që procesi zgjedhor të shtyhet, në mënyrë që gara të hapet për të gjithë dhe baza të ketë kohën e duhur për të shprehur vullnetin e saj pa presion dhe pa imponime. Dorëheqja e kryetarit, e shoqëruar me preferenca për pasuesin, krijon përshtypjen e skemave të sajura e të paragjykuara, të cilat nuk e çojnë partinë përpara. Unë jam qartësisht kundër çdo imponimi, kundër çdo tentative për të orientuar garën dhe kundër çdo formule që shpërfill bazën dhe delegatët", ka shkruar Hoxhaj. Ai ka thënë se PDK-ja ka nevojë për drejtim të ri, jo për skema të vjetra, "ka nevojë për vizion të ri, jo për ndërrim rolesh. Ky është momenti për t'i hapur rrugën ndryshimit të vërtetë".

TË HËNËN WESLEY CLARKU NIS DËSHMINË NË SPECIALE

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Dëshmia e gjeneralit amerikan Wesley Clark do të nisë të hënën e 17 nëntorit nga ora 12:00 në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë në rastin e gjykimit të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dëshmia e Clarkut pritet të zgjasë deri të mërkurën më 19 nëntor, pas saj do të mbahet edhe një konferencë për ecurinë e çështjes. Gjenerali Wesley Clark do të paraqitet si dëshmitar i

mbrojtjes së Hashim Thaçit para Dhomave të Specializuara në Hagë, pasi Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka konfirmuar lejimin e dhënies së dëshmisë. Dëshmia e Wesley Clarkut është e kufizuar në tema të përcaktuara - si përfshirja e tij në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999. Ajo do të fokusohet vetëm në përfshirjen dhe vëzhgimet e tij në Konferencën e Rambujesë, pasojat e saj dhe



rolet e UÇK-së. Po ashtu, ai do të flasë për rolin e Thaçit për demilitarizimin e UÇK-së pas luftës si dhe bisedat e takimet që kanë pasur së bashku me tani të akuzuarin. Veç kësaj, Clarku do të flasë edhe për njohuritë e tij për strukturën dhe organizimin e UÇK-së, vëzhgimet e tij mbi nivelin e kontrollit të Thaçit mbi UÇK-në dhe për përshtypjet e tij për zinxhirin komandues të UÇK-së.



KOSOVA ENDE NË UDHËKRYQ

Kriza institucionale në Kosovë vazhdon. Mes partive mungon besimi për t'u afruar për një zgjidhje politike. Por si do të dilet nga ky udhëkryq pritet të shihet këto ditë. Pas dështimit të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti për ta formuar qeverinë e re, presidentja Vjosa Osmani ka mandatuar sërish nga Lëvizja Vetëvendosje, kandidatin tjetër Glauk Konjufcën për ta krijuar mazhorancën. Por ende nuk kemi parë nëse Konjufca ka siguruar votat për ta formuar qeverinë e re

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Kosova vazhdon të jetë në krizë institucionale në pritje të tentimit të dytë për krijimin e qeverisë së re. Pas dështimit të kryeministrit në detyrë Albin Kurti për formimin e qeverisë së re, presidentja Vjosa Osmani ka mandatuar sërish nga Lëvizja Vetëvendosje, kandidatin tjetër, Glauk Konjufca, që ta krijojë mazhorancën. Për Albin Kurtin, liderin e Vetëvendosjes, që doli partia e parë në zgjedhjet e 9 shkurtit duke marrë 42 % të votave,

deputetët kanë vetëm dy opsione. "Deputetët e Kuvendit të Republikës janë para përzgjedhjes ose Kurti 2.5 deri në dhjetor, ose Konjufca 1 deri në prill, por pa asnjërën prej tyre nuk është e mundur". Por partitë opozitare të deritanishme nuk pranojnë imponime dhe e akuzojnë Kurtin për zvarritje të qëllimshme, me propozimin për qeveri të pakicës. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se "qytetarëve tanë tani po u propozohet si zgjidhje një qeveri

e pakicës për një periudhë kalimtare tranzitore për të trajtuar çështje shtetërore. Unitet tranzitor tash po i thonë, dhe natyrisht është i imponuar. Pra, jo me diskutim dhe dialog ndërpartiak, por me vendime të një partie politike". Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pret që seanca për qeverinë e re të thirret sa më shpejt. Ajo e ka mandatuar ndërkohë Glauk Konjufcën mandatar të dytë. "I mandatuari i dytë për kryeministër akoma është brenda afatit kushtetues. Pra, siç e dini, seanca duhet të ftohet brenda afatit kushtetues. Kanë mbetur edhe pak ditë. Shpresojmë që kjo të bëhet sa më parë që të jetë e mundur dhe të shohim rezultatin e kësaj seance".

Po nëse dështon Konjufca?

Kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, partia kryesuese që nuk

arriti në tentimin e parë ta krijojë mazhorancën, thotë se nëse edhe në tentimin e dytë nuk do ta arrijë këtë me bashkëpartiakun Konjufca, do të ketë zgjedhje të reja. Sipas Kurtit, këto mund të jenë qoftë në muajin dhjetor 2025, por edhe në pranverë 2026, kur duhet të zgjidhet edhe presidenti i vendit. "Tentimi i dytë, për bindjen tonë të fuqishme, përveçse i drejtë, është edhe obligim, në mënyrë që të bëhet çmos për t'u evituar zgjedhjet e reja. Është dëm i madh nëse detyrohemi të shkojmë në zgjedhje edhe në dhjetor, edhe në prill".

Bllokimi institucional kushton para

Në mungesë të Qeverisë së re të Kosovës dhe një Kuvendi ndonëse të konstituuar, por jo funksional, Kosova nuk mund të marrë ndihma nga plani i

BE-së për rritje sikundër nuk po mund ta miratojë as buxhetin për vitin 2026. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, shprehet se i ka ngritur këto çështje, por duhet vullneti i partive politike. "E kam ngritur edhe çështjen e planit të rritjes që është mbi 800 milionë euro, çështjen e marrëveshjeve me Bankën Botërore, që tani në fund të dhjetorit janë 100 milionë euro, por që janë edhe 200 milionë të tjera në fund të vitit që mund të humben nëse nuk ratifikohen. Pra, po flasim për një miliard euro që është një e katërta e buxhetit të Kosovës, që Kosova nuk do të duhej t'i humbiste, por t'i përfitonte. Krejt çka duhet është vullneti i partive politike në mënyrë që këto vendime të merren nga ky Kuvend, nga përfaqësuesit e këtij Kuvendi, të cilët janë votuar më 9 shkurt, por ende nuk kanë vendosur asgjë", ka theksuar Osmani.

OSMANI KRITIKON BE-NË QË S'PO E VLERËSON PUNËN E KOSOVËS: APLIKIMI YNË NË VITIN 2022 NDODHET NË SIRTARËT E TYRE, AS S'ËSHTË SHQYRTUAR

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në një intervistë për “Politico”, ka kritikuar Bashkimin Evropian meqë, sipas saj, Brukseli zyrtar duket se nuk e sheh dhe nuk e ndien përparimin që ka bërë Kosova.

Osmani në këtë intervistë ka thënë se Kosova nuk bën flirt me vende të tjera e fuqi keqdashëse si Rusia, Kina dhe Irani, të cilat i ka quajtur edhe si “trekëndëshi i së keqes”, por në të njëjtën kohë ndien se puna s'po i vlerësohet. Presidentja Osmani ka thënë se rruga integruese e Kosovës mbetet e bllokuar dhe, sipas saj, procesi i bazuar në merita, për të

cilin BE-ja flet aq shumë, ende s'po shihet në praktikë. “Por në të njëjtën kohë, nuk e ndiejmë që ky qasje pro-evropiane dhe fakti që ne jemi 100 për qind të përafuar me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së është parë ose vlerësuar. Përkundrazi, duket sikur merret si e mirëqenë. 97 për qind e njerëzve, sigurisht, janë pro-evropianë. Reformat tona në ekonomi, në sundim të ligjit, sidomos në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, kanë qenë thelbësore. Megjithatë, në rrugën tonë të integritetit evropian, jemi të bllokuar. Dhe duket sikur procesi i bazuar në meritë, për të

cilin BE-ja flet aq shumë, mbetet diçka që duhet të vijë. Unë ende nuk e shoh të ndodhë”, ka thënë Osmani në “Politico”.

Sa i përket mundësisë që Gjermania ta shtyjë përpara procesin integruës të Kosovës, Osmani ka thënë se shpreson që të ndodhë një gjë e tillë, meqë Kosova s'po kërkon bamirësi, por shtyrje përpara bazuar në merita. Më tutje, Osmani ka përmendur edhe faktin që Bashkimi Evropian (BE) ende s'e ka shqyrtuar aplikacionin e Kosovës për ta marrë statusin e vendit kandidat, duke thënë se ai s'është shqyrtuar dhe se ndodhet diku në sirtarët e BE-së. “Por shpresoj,

ashtu siç thatë ju, që Gjermania do të luajë atë rol udhëheqës në shtyrjen e një procesi të bazuar në meritë, sepse ne nuk po kërkojmë bamirësi. Nuk po kërkojmë rrugë të shkurtër. Po kërkojmë, pikërisht, respekt për punën që bëjmë dhe pranimin e reformave që ne ndërmarrim. Dhe nëse kjo do të merret parasysh, Kosova do të bëhej vendi udhëheqës. Por realiteti është se tani për tani aplikimi ynë as nuk është shqyrtuar. Ne aplikuan në dhjetor 2022, dhe tani jemi pothuajse në dhjetor 2025. Ai ndodhet diku në sirtarët e Bashkimit Evropian, por nuk po ecën përpara”, ka thënë Osmani.

Presidentja Osmani ka thënë se Kosova nuk duhet parë më si barrë. “Ne kemi popullsinë më të re në Evropë, e cila është e aftë, shumëgjuhëshe, më e mira në Evropën Juglindore për konkurrueshmëri në IT. Ata janë të shkëlqyer. Pra, është kapitali njerëzor, është potenciali ekonomik që është i madh. Në të njëjtën kohë, mendoj se duhet parë edhe si një domosdoshmëri strategjike. Ballkani Perëndimor që nuk është i paqes, i qëndrueshëm dhe i sigurt, do të thotë një Evropë që nuk është e paqes, e qëndrueshme dhe e sigurt”, ka deklaruar Osmani. (Express)



AAK-ja: Zgjidhja e vetme janë zgjedhjet e jashtëzakonshme

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e kryesisë, në të cilën kanë marrë pjesë edhe kryetarët e degëve, e të cilët kanë diskutuar dy tema kryesore: Zhvillimet politike në vend dhe përgatitjet për proceset e ardhshme politike, përfshirë zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

Kryesia e AAK-së konstatoi se gjendja aktuale në vend është alarmante, pa qeveri legjitime dhe pa funksionim të duhur të institucioneve. Kjo situatë, sipas AAK-së e rëndë politike dhe institucionale, kërkon veprim të menjëhershëm. “Në këto rrethana, zgjidhja e vetme dhe e domosdoshme janë

zgjedhjet e jashtëzakonshme, që qytetarët të rikthejnë legjitimitetin dhe besimin në institucionet e tyre”, thuhet në njoftimin e AAK-së. “Në pjesën e dytë të takimit, fillimisht u vlerësua lart suksesi i jashtëzakonshëm i Aleancës në zgjedhjet lokale, ku fituam bindshëm në pesë komunat ku kemi qeverisur. Ardian Gjini, Bali Muharremaj, Smajl Latifi, Bashkim Ramosaj dhe Zenun Elezaj dëshmuar se qeverisja e tyre ka qenë dhe vazhdon të jetë model i transformimit komunal duke konfirmuar besimin e qytetarëve me fitore të merituar e qeverisje të suksesshme. Në këtë frymë, Kryesia miratoi kriteret për



përpilimin e listës së kandidatëve për deputetë dhe nisjen e përgatitjeve në nivel të degëve për zgjedhjet e

ardhshme”, thuhet në njoftimin për medie. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka bërë me dije se nuk

do të jetë pjesë e asnjë procesi që e shkel Kushtetutën dhe e deformon rendin demokratik. “Ne kërkojmë që buxheti i ri të miratohet vetëm pas krijimit të Qeverisë së re me mandat të plotë. Aleanca nuk do të lejojë që Qeveria në detyrë të uzurpojë kompetenca që nuk i takojnë më. Ne mbrojmë integritetin institucional dhe rendin kushtetues të Republikës. Vendi ka nevojë për një buxhet të qeverisë legjitime, jo të qeverisë në ikje. Kjo nuk është çështje teknike, por parimore: S'ka buxhet pa Qeveri. S'ka vendimarrje pa mandat. S'ka demokraci pa respektim të Kushtetutës”, ka theksuar AAK-ja.

Smajl Latifi merr urime të shumta nga bashkëveprimtarë dhe qytetarë

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, pas fitores së balotazhit për zgjedhjet e 9 nëntorit, ka pritur shumë qytetarë, bashkëveprimtarë e miq në zyrën e tij,

të cilët i kanë uruar mandatin e ri qeverisëses. “Po ndaj me ju disa momente nga këto ditë, gjatë të cilave kam pasur kënaqësinë të pres miq, bashkëveprimtarë e qytetarë të

shumtë që më nderuan me urimet e tyre për fitoren në zgjedhjet për kryetar të komunës. Secili urim dhe çdo fjalë e mirë më ka dhënë forcë për përgjegjësinë që e kam.

Jam thellësisht mirënjohës për besimin tuaj! Vazhdojmë përpara, me punë konkrete dhe rezultate. Faleminderit për mbështetjen!”, ka shkruar Latifi në “Facebook”.



MINISTRI I MBROJTJES: SIGURIA KIBERNETIKE DUHET TRAJTUAR SI INVESTIM STRATEGJIK NË TË ARDHMEN

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Ministri i Mbrojtjes në detyrë, Ejup Maqedonci, mori pjesë si folës në panelin me temën “Impakti financiar i Sigurisë Kibernetike - investim apo shpenzim i domosdoshëm”. Në fjalën e tij, ministri Maqedonci theksoi se siguria kibernetike duhet trajtuar jo thjesht si shpenzim, por si investim strategjik në të ardhmen, që garanton mbrojtjen e infrastrukturës kritike, ruajtjen e të dhënave, funksionimin e institucioneve dhe besimin publik në sistemet digjitale. “Çdo



euro e investuar në mbrojtjen kibernetike është investim në stabilitet, zhvillim ekonomik dhe

siguri kombëtare”, tha ai. Duke e konsideruar sigurinë kibernetike si kërcënim real dhe

permanent, ministri theksoi se Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim të ngushtë ndërinstucional me Forcën e Sigurisë së Kosovës ka ndërmarrë hapa konkretë drejt forcimit të kapaciteteve mbrojtëse të vendit. Më tej, ai rikujtoi se siguria kibernetike është përfshirë si pjesë integrale në Strategjinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës si dhe në Strategjinë për Mbrojtje Kibernetike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Në këtë kuadër, ministri përmendi se në mars të vitit të kaluar është themeluar Qendra

Trajnuese për Siguri Kibernetike si dhe është formuar Njësia Kibernetike në kuadër të FSK-së - dy nisma kyçe që dëshmojnë përkushtimin institucional për zhvillimin e kapaciteteve profesionale, teknike dhe operacionale për mbrojtjen e vendit në hapësirën digjitale. Në përmbyllje të fjalës së tij, ministri Maqedonci potencoi se forcimi i sigurisë kibernetike nuk është vetëm detyrim institucional, por edhe domosdoshmëri kombëtare për garantimin e një të ardhmeje të sigurt, të qëndrueshme dhe të mbrojtur për qytetarët dhe vendin tonë.

MASHTI KA FILLUAR TRAJNIMIN E TRAJNERËVE PËR KURRIKULËN E RE PËR EFH

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me UNICEF-in, ka filluar procesin e trajnimit të trajnerëve për Kurrikulën e re për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme për fëmijët nga zero deri në gjashtë vjeç në Kosovë. Ky proces shënon përfundimin e një kapitulli dyvjeçar, me punë dhe përkushtim nga shumë aktorë për zhvillimin dhe pilotimin e Kurrikulës, i kurorëzuar me aprovimin e saj.

Njëkohësisht, ky është fillimi i një kapitulli të ri dhe të gjatë për zgjerimin e zbatimit të Kurrikulës, që fëmijët në edukimin e hershëm në nivel vendi të zhvillohen dhe mësojnë në një mjedis që mbështet lojën dhe eksplorimin e vazhdueshëm, si dhe një qasje edukative që bazohet në nevojat dhe interesat e fëmijëve, por që njeh rolin dhe pjesëmarrjen aktive të prindërve në edukimin e tyre. Trajnimi, i cili do të zgjasë pesë ditë, do të pasohet nga vlerësimi

dhe përzgjedhja e trajnerëve të Kurrikulës, duke mundësuar nisjen e ndërtimit të kapaciteteve të edukatorëve në nivel të Kosovës për zbatimin cilësor të saj dhe sigurimin e të drejtës së çdo fëmije për edukim cilësor dhe arritjen e potencialit të tij zhvillimor. Kjo punë u mundësua me mbështetjen financiare të Embassy of the Grand-Duchy of Luxembourg in Pristina dhe në bashkëpunim me Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim.



TË DIELËN PROTESTOHET NË STRASBURG PËR PADREJTËSITË NË HAGË

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Të dielën do të mbahet një protestë në Strasburg, Francë, para Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po gjykohen në Hagë. Thirrja për pjesëmarrje është bërë nga përfaqësuesi i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Evropë, Fatmir Koci, i cili në një prononcim për “Albanian Post” ka kërkuar mobilizim sa më të



madh nga shqiptarët kudo që jetojnë. “Thirrje gjithëpopullore për pjesëmarrje sa më të madhe

në Strasburg, për t'i dënuar padrejtësitë që po u bëhen krerëve të UÇK-së dhe luftës sonë

çlirimtare. Bashkohuni që t'i tregojmë botës se ne ishim çlirimtarë, jo agresorë. Ky proces është i fabrikuar nga Serbia dhe Rusia, sepse ne luftuam për lirinë tonë”, ka deklaruar Koci. Protesta organizohet nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVL-UÇK), ndërsa kryetari i saj, Hysni Gucati, ka konfirmuar se tubimi do të nisë në orën 13:00. Ai ka theksuar se protesta synon të jetë “zëri i drejtësisë për çlirimtarët”, duke

shtuar se përpjekjet për të bërë të dëgjuar qëndrimin e tyre në institucionet evropiane do të vazhdojnë. Tubimi në Strasburg vjen pas disa protestave të tjera të mbajtura muajve të fundit në Prishtinë, Hagë dhe Tiranë. Më 5 nëntor, pjesëtarë të OVL-UÇK-së protestuan para zyrave të EULEX-it në Prishtinë, ndërsa më 17 tetor në Tiranë mijëra qytetarë nga trevat shqiptare u mblodhën nën moton “Liri për çlirimtarët”.

ShSKUK-ja furnizohet me materiale të mjaftueshme për shërbimet e hemodializës

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se po realizohet furnizimi me materiale në sasi të nevojshme

për shërbimet e hemodializës në të gjitha njësitë në QKUK, por edhe në spitalet e përgjithshme. “Sqarojmë se, përkundër disa telasheve teknike gjatë

furnizimit në ditët e fundit, asnjë pacient nuk ka mbetur pa e marrë shërbimin e nevojshëm në QKUK dhe spitalet e përgjithshme. Furnizimi po

bëhet në sasi të mjaftueshme, konform kërkesave, për të siguruar kontinuitet të trajtimit të pacientëve”, ka njoftuar ShSKUK-ja.



HULUMTIMI: MUNGESA E BESIMIT, NDËR PENGESAT MË TË MËDHA PËR BASHKËJETESË NDËRETNIKE NË KOSOVË



Prishtinë, 14 nëntor - Ndasia midis komunitetit serb dhe atij shqiptar në Kosovë vazhdon të jetë e thellë, ndërsa marrëdhëniet ndërmjet tyre rëndohen edhe më shumë nga mosbesimi i madh, sipas një hulumtimi të organizatës joqeveritare Qendra për Veprime Shoqërore (CASA). Hulumtimi me titullin “Raporti mbi indeksin e besimit për gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë” u paraqit më 13 nëntor në Prishtinë.

Në këtë hulumtim u anketuan 800 veta, 500 nga komuniteti shqiptar dhe 300 nga ai serb. Hulumtimi bazohet në perceptimet e serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë për njëri-tjetrin, faktorët kryesorë që ndikojnë në marrëdhëniet e tyre dhe perspektivat për përmirësimin e tyre.

Më shumë se gjysma e të anketuarve nga komuniteti serb, mbi 51 për qind, besojnë se marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë do të përqeshen më tej, ndërsa rreth 28 për qind e shqiptarëve mendojnë të njëjtën gjë.

Studimi tregoi, gjithashtu, se të dy komunitetet - mbi 70 për

qind e të anketuarve - besojnë se tensionet politike midis Beogradit dhe Prishtinës kontribuojnë në përplasjet ndëretnike. Po ashtu, 79.6 për qind e të anketuarve shqiptarë e konsiderojnë Qeverinë e Serbisë nxitëse të tensioneve, ndërsa 74.5 për qind e serbëve mendojnë se për këtë është përgjegjëse Qeveria e Kosovës. Kur bëhet fjalë për faktorët që do të ndihmonin paqen dhe stabilitetin, mbi 62 për qind e serbëve besojnë se kjo do të ishte autonomia e tyre, ndërsa mbi 44 për qind e shqiptarëve mendojnë se zgjidhja është integrimi i serbëve në shoqërinë e Kosovës.

Miodrag Marinković, drejtor i CASA-s, vlerësoi se rezultatet e indeksit të besimit tregojnë se marrëdhëniet etnike midis serbëve dhe shqiptarëve janë të dëmtuara, dhe për këtë, në masë të madhe, përgjegjës janë politikanët nga Kosova dhe Serbia.

Ai theksoi se “politika populiste” që ndjekin të dyja palët ndikon negativisht në bashkëjetesë, në jetën e njerëzve të zakonshëm, në përditshmërinë e tyre dhe në procesin e pajtimit.

“Çlirimi nga frika dhe iluzionet është rruga drejt bashkëjetesës”

Visar Ymeri, drejtor ekzekutiv i Institutit Musine Kokalari në Prishtinë, gjatë një diskutimi në panel tha se komunitetet shqiptare dhe serbe në Kosovë përballen me dy problemet më të mëdha në lidhje me bashkëpunimin dhe bashkëjetesën: “jetojnë në frikë dhe në iluzion të ndërsjellë”. “Sipas tij, iluzioni te shqiptarët e Kosovës bazohet në idenë se Kosova është shtet shqiptar, që u përket shqiptarëve, ndërsa te serbët ekziston iluzioni se Kosova do të kthehet në kuadër të Serbisë. Nuk po flas për të gjithë shqiptarët apo serbët, por për sa kohë që ekzistojnë këto dy iluzione, situata nuk do të qetësohet kurrë”, tha ai. Ai shtoi se ekziston një frikë e vazhdueshme mes këtyre komuniteteve - shqiptarët kanë frikë se Serbia mund ta sulmojë Kosovën, ndërsa serbët se vendimet e autoriteteve kosovare mund t'i rrezikojnë. Marigona Shabiu, drejtoreshë ekzekutive e Iniciativës së të

Rinjve për të Drejtat e Njeriut - YIHR Kosova, theksoi se sulmi në Banjskë në vitin 2023 ndikoi ndjeshëm në polarizimin e shoqërisë në Kosovë, por edhe “veprimet e njëanshme të Qeverisë së Kosovës”, të cilat, sipas saj, kanë cenuar komunitetet joshumicë pasi nuk u është ofruar një zgjidhje alternative.

Në sulmin e armatosur të serbëve në Banjskë, në veri të Kosovës, u vra një polic i Kosovës, ndërsa më pas edhe tre sulmues. Përgjegjësinë për sulmin e mori përsipër Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë, e cila mbështetet nga Beogradi.

Nga ana tjetër, autoritetet e Prishtinës, që nga tërheqja e serbëve nga institucionet e Kosovës në nëntor 2022, kanë punuar aktivisht për vendosjen e kontrollit shtetëror në veri të Kosovës, përmes mbylljes së institucioneve të Serbisë, ndalimit të dinarit serb, targave serbe e masave të ngjashme.

Komuniteti ndërkombëtar ka kritikuar shumicën e këtyre hapave, pasi shumë serbë në veri marrin paga nga buxheti i

Serbisë dhe gëzojnë të drejta përmes sistemit institucional serb.

Darko Dimitrijeviq, kryeredaktor i “Radios Goraždevac”, konsideron se për përqeshimin e marrëdhënieve etnike përgjegjës janë kryesisht Beogradi dhe Prishtina, pasi vazhdimisht e fajësojnë njëri-tjetrin për gjendjen e keqe në shoqëri. “Ai narrativ toksik, ajo komunikim toksik, po vëzhgohet me shumë indiferencë nga bashkësia ndërkombëtare”, tha ai, duke shtuar se për këtë arsye edhe ajo mban një pjesë të përgjegjësisë.

Kosova dhe Serbia që nga viti 2011 zhvillojnë dialog për normalizimin e marrëdhënieve, gjatë të cilit janë nënshkruar dhjetëra marrëveshje, por shumë prej tyre nuk janë zbatuar në kurrë. Po ashtu, dialogu politik është bllokuar që nga viti 2023, pasi Kosova kërkon përgjegjësi për sulmin e armatosur në Banjskë. Serbia ka mohuar çdo përfshirje në këtë sulm, por refuzon ta dorëzojë Radoičiqin dhe të tjerët në Kosovë, ndaj të cilëve është ngritur aktakuzë për terrorizëm.

Murati: Asnjë qeveri nuk i ka rritur pensionet sikurse qeveria Kurti

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se asnjë qeveri nuk i ka rritur pensionet sikurse qeveria Kurti. Ai ka thënë se pensioni bazik të cilin e

gjetën me vlerë 90 euro/muaj në fillim të mandatit, prej të premtës ka theksuar se pensioni bazik procesohet me rritje me vlerë 150 euro/muaj. “Pra 60 euro rritje brenda mandatit, apo 67 %.

Ngjashëm edhe pensionet për personat me aftësi të kufizuara, të cilat i gjetëm me 75 euro/muaj dhe nga sot ato bëhen 150 euro/muaj, apo 100 % rritje brenda mandatit. Gjithashtu, kemi rritur edhe

mbështetjen për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, por edhe pensionin invalidor e atë familjar. Qeveria për pensionistët!”, ka shkruar Murati në “Facebook”.



ATK-ja DHE FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE ME PARTNERITET PËR PËRMIRËSIM TË SHËRBIMEVE DHE ZHVILLIM PROFESIONAL

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Mentor Hyseni, ka pritur në takim Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, prof. dr. Mirlind Bruçi, së bashku me stafin e tij mbështetës. Takimi u zhvillua në një frymë bashkëpunimi profesional, duke reflektuar angazhimin e të dy institucioneve për forcimin e partneritetit dhe zhvillimin e iniciativave të përbashkëta në fusha me interes të ndërsjellë. Gjatë diskutimeve palët shqyrtuan mundësitë për avancimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht

në fushën e zhvillimit të kapaciteteve në Teknologjinë e Informacionit, duke qenë se Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike përgatit kuadro profesionale të domosdoshme për modernizimin dhe digjitalizimin e proceseve brenda ATK-së. Palët shqyrtuan edhe çështje të tjera me rëndësi strategjike, që lidhen me avancimin e cilësisë së shërbimeve publike, forcimin e mekanizmave të transparencës dhe krijimin e vlerës së shtuar për qytetarët dhe tatimpaguesit përmes bashkëpunimit të ndërsjellë institucional. Diskutimet u përqendruan në identifikimin e fushave konkrete



ku ekspertiza akademike dhe teknike e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike mund të kontribuojë në përmirësimin e

proceseve operacionale të ATK-së, duke përfshirë analizën e kostove, zhvillimin e zgjidhjeve teknologjike dhe ndërtimin e

kapaciteteve profesionale. Administrata Tatimore e Kosovës mbetet e orientuar drejt krijimit të bashkëpunimeve që prodhojnë rezultate të matshme, veçanërisht në ndërtimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale që ndihmojnë modernizimin e proceseve të saj të brendshme. Përmes partneriteteve të tilla ATK-ja synon ta forcojë bazën analitike dhe teknologjike të institucionit, ta rrisë efikasitetin në ofrimin e shërbimeve dhe ta përmirësojë ndërveprimin me tatimpaguesit në përputhje me standardet bashkëkohore të administrimit tatimor.

ZËVENDËSGUVERNATORI CAKAJ: MENAXHIMI STRATEGJIK I RREZIQEVE, THELBËSOR NË NJË TREG FINANCIAR QË PO NDRYSHON ME RITME TË SHPEJTA

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Milot Cakaj, mori pjesë në forumin “Menaxhimi i Rreziqeve 2025 - Menaxhimi strategjik i rreziqeve për një sektor bankar të qëndrueshëm në Kosovë”, organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës (ShBK), një ngjarje që mbledhi drejtues të institucioneve financiare dhe partnerë ndërkombëtarë për të



diskutuar për qasjet strategjike në menaxhimin e rrezikut dhe forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit bankar. Zëvendësguvernatori Cakaj në fjalën e tij gjatë hapjes së punimeve të këtij forumi theksoi rolin që ka BQK-ja në stabilitetin financiar të vendit si dhe rëndësinë e dialogut mbikëqyrës. Ai nënvizoi se menaxhimi strategjik i rreziqeve është thelbësor në një treg financiar që po ndryshon me ritme të shpejta dhe se BQK-ja

do të vazhdojë ta forcojë qasjen e saj mbikëqyrëse përmes avancimit të kornizës mbikëqyrëse dhe metodologjisë sipas rregullativës së Bashkimit Evropian. Në vijim të forumit, vëmendje të posaçme mori paneli i diskutimit, ku drejtori i Mbikëqyrjes Bankare në BQK, Terziqi, paraqiti qëndrimet e institucionit rreth zhvillimeve financiare dhe sfidave të tregut. Ai shtjelloi rëndësinë e ruajtjes së balancit mes rritjes së

qëndrueshme dhe stabilitetit si dhe nevojën për qasje proaktive në menaxhimin e likuiditetit, kërkesave për kapital dhe strategjive të financimit duke iu përshtatur modeleve të reja të biznesit sipas kushteve të reja. Gjatë forumit BQK-ja u vlerësua për rolin e saj mbikëqyrës dhe për angazhimin e vazhdueshëm në zhvillimin e një sektori financiar të qëndrueshëm, transparent dhe të orientuar drejt standardeve më të mira ndërkombëtare.

MERZ: GJERMANIA KA NEVOJË PËR PUNËTORË TË KUALIFIKUAR!



BERLIN, 14 NËNTOR - Kancelari gjerman Friedrich Merz ka përsëritur edhe njëherë që Gjermania ka nevojë për fuqi të kualifikuar punëtorë nga vendet e tjera. Merz dhe ministri i Brendshëm Dobrindt thonë se njëkohësisht me dëbimin e atyre që nuk kanë të drejtë të rrinë në Gjermani, ata angazhohen për

ardhjen e fuqisë së kualifikuar punëtorë dhe mbetjen në këtë vend të personave të integruar mirë. “Ne kemi nevojë për punëtorë të kualifikuar”, tha Merz dhe shtoi: “Gjermania është një vend i hapur, i lirë, liberal dhe tolerant”. Sipas të dhënave të fundit, në Gjermani papunësia është diku

rreth tre milionë. Por rreth 600.000 vende pune akoma janë të lira, për shkak se në shumicën prej tyre kërkohen punëtorë të kualifikuar që i mungojnë Gjermanisë. Merz tha se Gjermania ka vendosur të hapë edhe një Agjenci me emrin “Work-and-Stay”, e që do të ndihmojë ardhjen dhe integrimin më të

mirë të punëtorëve të huaj. Edhe ministri i Brendshëm, Alexander Dobrindt, tha se të gjithë ata që janë të integruar mirë në vend, duhet të kenë një shans, e kjo vlen edhe për sirianët e integruar mirë. “Por ata që nuk integrohen, që nuk punojnë, nuk kanë perspektivë në këtë vend dhe duhet të kthehen në Siri”, tha ai.

Qeveria në detyrë merr tri vendime

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Qeveria në detyrë ka mbajtur mbledhje elektronike në të cilën ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Financave,


Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet). Po ashtu,

ka miratuar kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për Reformulimin e pikës 2 të Vendimit të Qeverisë nr.

09/273 të datës 31 tetor 2025. Gjithashtu ka emëruar Jetmir Hazirin në pozitën e drejtorit ekzekutiv të Agjencisë për Regjistrim Civil.



A JANË DOSJET EPSTEIN TË VËRTETA?



Demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve publikuan email-e nga trafikanti famëkeq i seksit Jeffrey Epstein, të cilat pretendojnë, ndër të tjera, se Donald Trump kaloi orë të tëra në shtëpinë e Epstein me një nga viktimat e tij.

Një gazetar e pyeti sekretaren e Shtypit të Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt, nëse kjo ishte e vërtetë.

“Këto email-e,” u përgjigj ajo, “nuk vërtetojnë absolutisht asgjë tjetër përveç faktit se Presidenti Trump nuk bëri asgjë të gabuar.” Kjo nuk është një jo.

Nga të gjitha skandalet e Trump, marrëdhënia e tij me Epstein – nëse injoroni numrin e madh të viktimave njerëzore – mund të jetë burimi më i pasur i komedisë së zezë.

Disa nga adhuruesit më të përkushtuar të Trump zgjodhën çështjen e keqbërjeve të Epstein dhe kabalin e supozuar të mbështetësve të elitës si fantazinë mbi të cilën ata projektuan një rol të guximshëm për heroin e tyre.

Trump duhej të publikonte me guxim të gjitha provat e disponueshme për shqyrtim publik.

Në vend të kësaj, ky skandal ka rezultuar ta implikojë atë personalisht.

Mbrojtja e Trump në këtë çështje ka qenë se dosjet e Epstein janë një mashtrim, i sajuar për ta njollësuar atë nga “Obama, Hillary e pandershme, Comey,

Brennan dhe Humbësit dhe Kriminelët e Administratës Biden”.

Por ai gjithashtu ka vendosur ta lërë çështjen mënjanë sepse ky konspiracion që përfshin CIA-n, FBI-në dhe dy presidentë për ta lidhur atë në mënyrë të rreme me një milioner kriminel që vdiq në mënyrë të dyshimtë është thjesht shumë i mërziqshëm për t’u interesuar nga askush.

“Nuk e kuptoj pse do të ishin kaq të interesuar. Ai ka vdekur prej kohësh”, tha Trump për Epstein në korrik.

Zbulimet e fundit i kanë shtyrë Trump dhe aleatët e tij të përditësojnë mbrojtjen e tyre. Përgjigja e tyre ka po aq kuptim sa ajo që erdhi më parë.

Raundi i parë i kundërshtimeve u përqendrua në kohën e dyshuar të publikimit të email-it, kaq shpejt pasi disa demokratë vendosën të ndihmonin në përfundimin e mbylljes – një veprim që ka fituar disa tallje nga baza e tyre.

“Liberalët pothuajse e kanë mbaruar shkatërrimin e qeverisë amerikane pa asnjë arsye të dallueshme, kështu që natyrshëm po e zhvendosin fokusin te një pedofil i vdekur”, tha strategu konservator Josh Holmes në X.

“Mos i kushtoni vëmendje demokratëve që shkatërrohen”, ndërhyri Erick Erickson me sarkazëm.

Nuk është gabim të thuhet se koha e publikimit lidhet me

mbylljen e qeverisë, në kuptimin që kur Dhoma e Përfaqësuesve të kthehet në seancë, anëtarët që mbështesin publikimin e dosjeve të Epstein do të kenë shumicën.

Demokratët po përpiqen qartë të bëjnë presion mbi një numër të vogël republikanësh mbështetës të Dhomës së Përfaqësuesve që të ruajnë mbështetjen e tyre.

Trump po lobon tek ata që të braktisin peticionin, si privatistisht ashtu edhe në kanalën e tij në mediat sociale.

Por zbulimet janë paksa shumë dënuese për t’u konsideruar si një lëvizje e ciklit të lajmeve, kështu që Shtëpia e Bardhë ndoqi një qasje të ndryshme disa orë më vonë.

Ajo lëshoi një deklaratë duke vënë në dukje se viktimat e paidentifikuar në emailin e Epstein që “kaloi orë të tëra” me Trump në shtëpinë e Epstein ishte Virginia Giuffre, e cila “tha vazhdimisht se Presidenti Trump nuk ishte i përfshirë në asnjë shkelje”.

Rapid Response 47, një llogari zyrtare e Shtëpisë së Bardhë X, lëshoi një mesazh duke vënë në dukje se në kujtimet e saj të reja pas vdekjes për mbijetesën e abuzimit të Epstein, Giuffre thotë se Trump ishte miqësor dhe se ai i ofroi ta ndihmonte të gjente punë si dado.

Më vonë, rrëfimi shtoi: “Demokratët e fshinë emrin e viktimës sepse viktimat tha se Trump ‘nuk mund të kishte qenë

më miqësor’, ishte një ‘zotëri’ dhe se nuk kishte qenë dëshmitare e ndonjë shkeljeje.”

Takimi ishte krejtësisht i pafajshëm – vetëm disa orë ku Trump po shkëmbente ide për klientët që kujdeseshin për fëmijët, një akt i njohur bujarie nga një burrë i njohur për pasionin e tij për mentorimin e të rinjve.

Përgjigja e Shtëpisë së Bardhë ngre disa pyetje.

Së pari, biseda që Giuffre kujtoi të kishte pasur me Trump u zhvillua në Mar-a-Lago.

Emaili në fjalë përshkruante një takim në shtëpinë e Epstein, ku ndërveprimi mund të ketë përfshirë më shumë sesa këshilla për kujdesin e fëmijëve.

Për më tepër, kontekstualizimi i këtij emaili duke vënë në dukje se cilën vajzë përfshinte është një mënyrë e çuditshme për t’iu përgjigjur një dokumenti “të rremë”.

Emaillet e Epstein nënkuptojnë gjithashtu se Trump ishte në dijeni të skemës së tij të trafikimit seksual.

“Sigurisht që ai dinte për vajzat”, shkroi Epstein në një email.

Nëse do të takoja një adoleshente që e dija se ishte një viktimë e mundshme e një rrjeti trafikimi seksual, do të doja të mendoja se do të përpiqesha t’i ndihmoja ata të kontaktonin zbatimin e ligjit ose të largoheshin.

Gjithashtu, nëse zbuloja se një mik i ngushtë drejtonte një rrjet

trafikimi seksual, ndoshta do ta rishqyrtoja miqësinë tonë, në vend që të angazhohesha në biseda të gjata e të këndshme me viktimat e tij.

Përgjigjet e Shtëpisë së Bardhë përputhen me një model sjelljeje të dyshimtë nga presidenti në këtë çështje.

Trump ka thënë për bashkëpunëtoreshen e Epstein, Ghislaine Maxwell, “I uroj gjithë të mirat” – një gjë e çuditshme për t’u thënë për një kriminel të dënuar që abuzoi sistematikisht me vajza të reja.

Administrata e tij i ka dhënë asaj një përmirësim të lehtë të statusit për kohën e saj në burg, duke përfshirë një transferim në një kamp sigurie minimale dhe vizita për qenushët.

Kjo duket si një shkëmbim shpërblimi.

I pyetur nëse Trump do ta falë Maxwell, Leavitt u përgjigj: “Nuk është diçka për të cilën ai po flet ose as po mendon në këtë moment.”

Në këtë moment nuk e mbyll derën pikërisht për këtë mundësi.

A janë dosjet e Epstein papritmas të vërteta? Apo janë disa prej tyre të vërteta dhe disa prej tyre të rreme?

E tëra çfarë dimë është se Trump dëshiron që ne të ndalojmë së foluri për këtë temë.

Kjo është zakonisht ajo që dëshironi kur tema përfshin prova se jeni sjellë në një mënyrë përtej çdo qortimi.

SENSORËT QË LEXOJNË MENDIMET

Lidhja e mendjes me pajisjet elektronike dhe kontrolli i tyre pa lëvizur as gishtin. Është kufiri i ri që do të ndryshojë mjekësinë, dhe ndoshta, edhe vetë njeriun.



Matt Nagle ishte 21 vjeç dhe një lojtar premtues i futbollit amerikan, kur më 3 korrik 2001 ndërhyri në një sherr për të mbrojtur një mik. Një goditje me thikë në qafë i preu plotësisht palcën kurrizore, ose rrugën nervore që lidh trurin me pjesën tjetër të trupit. Ylli në ngjitje i futbollit mbeti i paralizuar nga qafa e poshtë.

Tre vjet më vonë, në Massachusetts General Hospital të Bostonit, një ekip neurokirurgësh i hapi kafkën dhe i futi në korteksin motorik 96 mikroelektroda silikoni, të vendosura mbi një çip 4x4 milimetra. Disa javë më vonë, në laborator, pajisja u lidh me një kompjuter që analizonte sinjalet që vinin nga truri. Për rreth një vit, gjatë 57 seancave eksperimentale, Matt arriti të përdorte vetëm me fuqinë e mendjes një kompjuter, përmes të cilit mund të lexonte e-mail-et, të komandonte një krah robotik dhe të ndryshonte kanalet e televizorit. Eksperimenti kishte dalë me sukses dhe, për arsye sigurie, pajisja u hoq.

Rezultatet provuan se është e mundur të regjistrohen sinjalet nga korteksi motorik i një personi që nuk mund të lëvizë më, dhe t'i mundësohet atij të kontrollojë një pajisje të jashtme.

Nga truri te kompjuteri

Publikuar në revistën Nature në vitin 2006, studimi bënte pjesë në projektin shkencor BrainGate, që vazhdon ende sot nën drejtimin e John P. Donoghue, neuroshkencëtar në Brown University të Rhode Island (SHBA). Rezultatet e arritura me Matt konsiderohen ende një gur

themeli në historinë e ndërfaqeve tru-kompjuter, pajisje të zhvilluara fillimisht për t'u dhënë pavarësi personave të paralizuar, por që mund të rikthejnë edhe funksione të tjera të humbura për shkak të dëmtimeve ose sëmundjeve nervore.

“Ndërfaqet tru-kompjuter kapin sinjalet e trurit, i analizojnë dhe i përkthejnë në komanda që mund të përdoren për të kontrolluar një pajisje të jashtme, në përputhje me aktivitetin nervor të regjistruar”, shpjegon Silvestro Micera, profesor i bioelektronikës në Scuola Superiore Sant’Anna dhe i neuroinxhinierisë translacionale në Politeknikun e Lozanës.

Nuk ka kufi për llojin e pajisjeve që mund të kontrollohen në këtë mënyrë, sepse në thelb, siç sqaron Pietro Mortini, drejtor i Neurokurgjisë në San Raffaele të Milanos, “bëhet fjalë për të bërë që truri, i cili funksionon përmes impulseve elektrike, të komunikojë me pajisje që përdorin të njëjtin lloj sinjali.” Kështu, përveç kompjuterëve dhe krahëve robotikë, pacientët kanë arritur të kontrollojnë sintezues zanorë, proteza, madje edhe stimulatorë që, të implantuar në palcën kurrizore ose në muskuj, u kanë mundësuar të lëvizin gjymtyrët e paralizuar.

Dekodifikimi i sinjaleve nervore

Elementët kyç të çdo ndërfaqeje tru-kompjuter janë sensorët, që mbledhin sinjalet cerebrale, dhe algoritmet, dhe më pas i deshifrojnë dhe i kthejnë në veprime, shpesh duke përdorur

inteligjencën artificiale.

Metoda e parë për regjistrimin e aktivitetit elektrik të trurit ishte elektroencefalogrami (EEG), i shpikur një shekull më parë nga psikiatri gjerman Hans Berger. Kjo teknikë u përdor për eksperimente që në vitet '60 e '70, fillimisht te majmunët dhe më pas te pacientët që arritën të kontrollojnë karriget me rrota me mendje.

“Në disa raste, EEG mund të jetë ende i dobishëm, sepse është më pak invaziv dhe më i lehtë për t'u përdorur”, thotë Micera.

“Por sinjalet që ofron janë më të dobëta dhe më pak precize se ato që merren nga elektrodët e vendosur drejtpërdrejt në tru, përmes operacioneve me kranium të hapur.”

Këta sensorë mund të jenë pllakëza silikoni të vendosura mbi korteks (teknika e elektrokortikografisë) ose mikroelektroda shumë të holla që futen në indin nervor për të kapur aktivitetin e neuroneve, siç bën Neuralink, kompania e Elon Musk. Në vitin e kaluar, në JAMA Neurology, studiuesit e Universitetit të Melburnit, të financuar nga kompania Synchron, prezantuan stentrodën, një “manikë” latex 4 cm të gjatë, me 16 elektroda platini. E futur përmes venës jugulare, ajo arrin pranë korteksit motorik dhe regjistron sinjalet elektrike të neuroneve, duke i transmetuar pa kabllo tek një kontrollues i jashtëm. Pajisja rezultoi e sigurt dhe u mundësoi 4 pacientëve me paralizë të përdornin kompjuterin në shtëpi për 12 muaj.

“Prania e kompanive si Neuralink dhe Synchron, së bashku me investimet në rritje, tregojnë se ndërfaqet tru-kompjuter janë tashmë një teknologji e pjekur, gati për hyrje në treg”, komenton

Micera.

Fitimi i lëvizjes

Një drejtim tjetër kërkimi po zhvillon sisteme që stimulojnë muskujt ose palcën kurrizore për të rikthyer lëvizjen te pacientët me paralizë. Në vitet 2016–2017, dy studime në Nature dhe The Lancet treguan për herë të parë që kjo është e mundur:

Në SHBA, studiuesit i implantuan Ian Burkhartit, një 24-vjeçar i paralizuar, një çip me 100 elektroda në korteksin motorik dhe një stimulues muskolor me 130 elektroda në krah. Pas 18 muajsh stërvitjeje, ai arriti të lëvizte dorën. Në një tjetër rast, një burrë 53-vjeçar tetraplegjik, me dy sete elektrodash në tru dhe 36 në krah, arriti pas disa muajsh të lëvizte dhe të shërbente vetë një kafe.

Përtej karriges me rrota

Që nga viti 2016, ekipi i Jocelyne Bloch dhe Grégoire Courtine në Lozanë, në bashkëpunim me Silvestro Micera, ka zhvilluar një stimulator të palcës kurrizore me 16 elektroda që aktivizon zonën e dëmtuar.

Në Nature Medicine (2022), pajisja, e kontrolluar përmes një tableti, i lejoi pacientët të ecin me ndihmën e një deambuluesi, madje të pedalojnë, notojnë apo rremojnë.

Në një fazë të mëvonshme, pajisja u lidh me një ndërfaqe tru-kompjuter me 64 elektroda në sipërfaqen e korteksit. Përmes komunikimit pa kabllo me një kompjuter të vogël që mbahej në shpinë, 40-vjeçari Gert-Jan Oskam, tetraplegjik pas një aksidenti, arriti të ecë sërish në mënyrë natyrale.

Në Itali, San Raffaele në Milano është i pari që ka nisur të implantojë këtë pajisje. “Deri tani kemi operuar 7 pacientë, të gjithë më parë në karrige me rrota”, tregon Pietro Mortini. “Tani ecin me deambulues dhe përmirësohen çdo ditë. Presim progres deri në një vit e gjysmë pas operacionit.”


T'u rikthesh zërin atyre që nuk flasin më

Së fundmi, kërkimet po shtrihen edhe tek rikthimi i të folurit te personat që kanë humbur aftësinë për të komunikuar. Elektrodët vendosen në zonat e trurit që kontrollojnë organet e artikullimit, buzët, gjuhën, faringun, dhe sinjalet përdoren për të komanduar sintezues zanorë ose për të shkruar tekst.

Në Nature (2023), ekipi i Edward Chang në Universitetin e Kalifornisë, San Francisco, arriti të rikrijojë zërin e Ann, një gruaje 47-vjeçare që kishte humbur aftësinë për të folur prej 17 vitesh pas një goditjeje në tru. Sinjalet e saj cerebrale u deshifruan me deep learning, duke animuar një avatar që fliste me zërin e saj origjinal, të rikonstruktuar nga videot e dasmës.

Në Universitetin e Stanfordit, Frank Willett dhe Krishna Shenoy arritën të përkthejnë sinjalet nervore të një pacienti me sklerozë laterale amiotrofike në tekst të shkruar.

Shpejtësia e “shkrimit me mendje” tashmë afrohet me ritmin e të folurit normal, dhe falë algoritmeve të korrigjimit automatik, të ngjashme me ato të celularëve, niveli i saktësisë ka arritur nën 5% gabime, sipas një studimi të New England Journal of Medicine (2024). / bota.al



Kosova sonte luan për histori ndaj Sllovenisë

Prishtinë, 14 nëntor - Kombëtarja e Kosovës ka bërë të gjitha përgatitjet për ndeshjen vendimtare ndaj Sllovenisë e cila do të zhvillohet sonte (e shtunë) në orën 20:45 dhe është vlerësuar një "finale" për fatin e kualifikimeve drejt Kupës së Botës 2026. Ekipi të premten ka

përfunduar të gjitha përgatitjet për këtë ndeshje dhe ka arritur në Lubjanë. Përzgjedhësi Franco Foda e ka fokusuar punën në aspektet taktike, duke i dhënë rëndësi organizimit dhe qartësisë së detyrave për secilin lojtar. Lajmi më i mirë për stafin

teknik është se të gjithë futbollistët janë në formë të shkëlqyer dhe plotësisht gati për sfidën ndaj Sllovenisë. Një fitore në Slloveni do të ishte historike për Kosovën, pasi do t'i siguronte për herë të parë pjesëmarrjen në fazën "play-off" të Botërorit.

Pas duelit në Lubjanë, Kosova do ta mbyllë ciklin kualifikues me supersfidën ndaj Zvicrës në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kujtojmë se Kombëtarja e Kosovës ka shënuar përparim historik pas rezultateve të shkëlqyera në kualifikimet për



Botërorin 2026, duke arritur vendin e 84-të në renditjen më të fundit, ka njoftuar faqja zyrtare e FIFA-s.

HISTORIA SHKRUHET NË ANDORRA, SHQIPËRIA SIGURON FAZËN E "PLAY-OFF"-IT PËR BOTËRORIN

TIRANË, 14 NËNTOR - 13 nëntori do të shkruhet me shkronja të arta në historinë e futbollit shqiptar. Kombëtarja e Shqipërisë ka fituar me rezultat 0-1 në transfertë ndaj Andorrës dhe ka siguruar për herë të parë në histori pjesëmarrjen në fazën "play-off" të Kampionatit Botëror 2026. Në fitoren historike, formacioni titullar ishte: Strakosha (GK), Gjimeshi (c), Ajeti, Hysaj, Mitaj, Shehu, Laçi, Asllani, Hoxha, Broja dhe Manaj. Kuqezinjtë e kanë nisur ndeshjen me dominim të plotë në pjesën e parë, duke kontrolluar lojën dhe qarkullimin e topit, edhe pse rastet e pastra për gol ishin të pakta. Në minutën e 17, Kristjan Asllani ishte pranë golit pas një goditjeje dënimi ballore, por topi përfundoi pak mbi traversë. Shqipëria ka vijuar ta kërkonte avantazhin me qarkullim të mirë të topit dhe presion konstant, por pa

arritur konkretizimin. Rasti më i mirë i kësaj pjese ka ardhur pas një goditjeje nga këndi, kur Berat Gjimeshi është ngjitur më lart se mbrojtësit kundërshtarë dhe goditi me kokë, por topi u përplas në traversë. Në vijim të aksionit, përpjekja e Rey Manajt ka shkuar jashtë traversës. Pjesa e parë është mbyllur pa gola. Në pjesën e dytë, kuqezinjtë kanë zhvilluar një lojë pothuajse e përkryer, duke kontrolluar plotësisht ritmin dhe duke krijuar disa raste të rrezikshme për gol. Në minutën e 47, pas një harkimi nga e djathta, Kristjan Asllani pason me thembër për Arbër Hoxhën, por gjuajtja e tij është devijuar në këndore nga mbrojtja kundërshtarë. Pak çaste më vonë, Armando Broja ka depërtuar në zonë dhe ka tentuar të gjuajë, por portieri ka reaguar duke larguar topin. Në vijim të aksionit, topi ka



përfunduar tek Asllani, i cili ka provuar nga jashtë zonës, por sërish portieri ka ndalur dhe mbrojtja e Andorrës ka pastruar çdo rrezik. Në minutën e 60, trajneri Silvinjo ka kryer dy zëvendësimet e para. Broja dhe Laci kanë lënë

fushën për t'u bërë vend Nedim Bajramit dhe Myrto Uzunit. Asllani ka vazhduar të jetë protagonist me disa tentativa, por shpërblimi ka ardhur në minutën e 67. Pas një kundërsulmi të shpejtë të nisur nga Uzuni në krahun e djathtë,

topi ka shkuar tek Asllani, i cili nuk ka gabuar dhe e ka dërguar në rrjetë, duke kaluar Shqipërinë në avantazh. Në minutën e 73-të, një tjetër rast i artë ishte për kuqezinjtë. Bajrami ka gjuajtur fort nga jashtë zonës, tentativa e tij devijohet nga Rey Manaj dhe ka përfunduar jashtë kuadrantit të portës. Më pas, Silvinjo ka bërë sërish dy zëvendësime, duke aktivizuar Indrit Tucin në vend të Rey Manajt për ta freskuar repartin e sulmit. Kuqezinjtë kanë administruar në mënyrën më të mirë minutat e mbetura, duke mbajtur kontrollin e lojës deri në fund. Andorra - Shqipëri ka përfunduar me rezultatin 0-1 në favor të kuqezinjve, një fitore historike që vulos pjesëmarrjen e Shqipërisë në fazën "play-off" të Kampionatit Botëror 2026, për herë të parë në histori. Në ndeshjen tjetër të grupit, Anglia ka mposhtur Serbinë me rezultatin 2-0.

PËRBALLJA E TË PAMPOSHTURVE, BASHKIMI SOT LUAN KUNDËR PEJËS

Prishtinë, 14 nëntor - Të pamposhturit e ProCredit Superligës do të përballen në sot (e shtunë) në kuadër të xhiros së gjashtë në basketboll. Bashkimi - GO+ Peja është derbi i kësaj xhiroje. Të dyja skuadrat kanë nga pesë fitore nga pesë ndeshje, duke treguar formë shumë të mirë në garat e elitës. Të dyja skuadrat hyjnë për fitore dhe vazhdojnë të jenë të

pamposhtura në ProCredit Superligë. Bashkimi garon në grupet e FIBA Europe Cup, derisa GO+ Peja në grupet e Ligës ENBL, duke dëshmuar se skuadrat kanë nivel të lartë të organizimit dhe suksesit. Ndeshjet mes këtyre dy skuadrave kanë qenë gjithmonë interesante dhe kështu pritet edhe të shtunën mbrëma në Prizren. Java e gjashtë do të hapet me duelin interesant ndërmjet



Golden Eagle Yllit dhe Borës. Therandasit kanë një fitore e katër humbje, ndërsa prishtinasit janë të vetmit pa fitore, pasi kanë

pësuar në katër ndeshje. Trepça - Rahoveci 029 do të luhet nesër (e diel) në Mitrovicë. Kampionët e Kosovës kanë dy fitore e dy humbje, kurse "Vreshtarët" dy fitore e tri humbje. Kjo xhiro do të mbyllet me duelin ndërmjet Vëllaznimit dhe Sigal Prishtinës. Kuqezinjtë kanë një fitore e katër humbje, ndërsa bardhekaltrit tri fitore e dy humbje.

PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 6

SOT (E SHTUNË)

17:00 Golden Eagle Ylli - Bora
19:00 Bashkimi - GO+ Peja

NESËR (E DIEL)

17:00 Trepça - Rahoveci 029
19:00 Vëllaznimi - Sigal Prishtina

Mbappe: 400 golat nuk mjaftojnë kur Ronaldo dhe Messi kanë mbi 900

Paris, 14 nëntor - Kylian Mbappe ka komentuar arritjen e tij të fundit, 400 gola në karrierë, por deklarata e tij ka surprizuar të gjithë, pasi francezi ka lënë të kuptohet se ky numër nuk është aspak i mjaftueshëm për standardet që

ai synon. "Ka një lojtar me mbi 950 gola dhe një tjetër me mbi 900. 400 nuk mjaftojnë që të qëndrosh në rrethin e lojtarëve që i shokojnë njerëzit", ka thënë Mbappe, duke iu referuar qartë Cristiano Ronaldos dhe Lionel

Messit, dy golashënuesve më të mëdhenj në historinë e futbollit. Deklarata e tij tregon ambicien e jashtëzakonshme që e karakterizon sulmuesin francez, i cili, megjithëse është bërë lojtari më i ri që arrin 400 gola që nga koha e Peles, duket se e

konsideron këtë vetëm si fillimin e një rruge shumë më të gjatë. Në moshën 26-vjeçare, Mbappe synon jo vetëm ta sfidojë rekordin e gigantëve të futbollit modern, por të hyjë vetë në historinë e lojës si një prej më të mëdhenjve të të gjitha kohëve.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Elektro Instalues XAJA” SH.P.K. me seli në Rahovec, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812241355 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Elektro Instalues XAJA” D.O.O. Rahovec donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812241355 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Elektro Instalues XAJA” L.L.C. with headquarters Rahovec, has come to the decision to quit its business: 812241355 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “La Vie En Shine” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812278746 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “La Vie En Shine” D.O.O. Fushë Kosovë donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812278746 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “La Vie En Shine” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 812278746 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “BBF Company” Shpk, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, Fabrikë për prodhimin dhe ambalazhimin e pijeve freskuese dhe energjike, Varosh Ferizaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.01.2026 në ora 10:00 në në SHFMU "Visar Dodoni", në Varosh-Ferizaj, Adresa: Varosh-Ferizaj, Komuna e Ferizaj, do të organizohet debat publik nga “BBF Company” Shpk, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/2693380475?pwd=ZEpzTUNmaHlTRVN3VXZqRU5kaXRTUT09>

Meeting ID: 269 338 0475

Passcode: BBqP2x

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “BBF Company” Shpk, Ferizaj, për Pëlqim Mjedisor, për Fabrikën për prodhimin dhe ambalazhimin e pijeve freskuese dhe energjike, Varosh Ferizaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Alban Ferati shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “22 Dëshmorët” Randobravë Prizren.

- Edmond Rrafshi shpall të pavlefshme 4 dëftesat, certifikatën dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Etrut Duraj shpall të pavlefshme dëftesën dhe diplomën sh.m.e. “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Dren Spahiu shpall te pavlefshme 3 dëftesat, certifikatën dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Reshat Saramati shpall të pavlefshme 1 dëftesë QK “11 Marsi” Prizren.

- Qendrim Hajdari shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë Teknike “Arkitekt Sinani”.

- Mirsad Beka shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Bislim Imeri” Kqiq i madh.

- Shefki Cafleshi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Eva Aline Coupet shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës “Naim Frashëri” kl. VI-IX.

- Eva Aline Coupet shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të shkollës “Don Bosko”.

- Shkolla Fillore dhe e Mesme “Zenit” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. Serik 3011785 me nr. Unik Identifikues: 810797160.
- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, bane-sa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dymuaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

